

VENDIM
Nr. 405, datë 3.6.2026

**PËR PËRCAKTIMIN E TARIFAVE PËR LËSHIMIN E DOKUMENTEVE
LIGJORE PËR TRANSFERIMIN NDËRKOMBËTAR TË MALLRAVE
USHTARAKE DHE TË ARTIKUJVE E TEKNOLOGJIVE ME PËRDORIM TË
DYFISHTË, QË LËSHOHEN NGA AUTORITETI I KONTROLLIT SHETËTOR
TË EKSPORTEVE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1, të nenit 46, të ligjit nr. 46/2018, “Për kontrollin shtetëror të transferimeve ndërkombëtare të mallrave ushtarake dhe të artikujve e teknologjive me përdorim të dyfishtë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Përcaktimin e tarifave për lëshimin e dokumenteve ligjore për transferimin ndërkombëtar të mallrave ushtarake dhe të artikujve e teknologjive me përdorim të dyfishtë, që lëshohen nga Autoriteti i Kontrollit Shtetëror të Eksporteve, sipas lidhjes nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Të ardhurat e mbledhura nga tarifat e përcaktuara në këtë vendim do të derdhen në buxhetin e shtetit.

3. Vendimi nr. 202, datë 10.4.2019, i Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e tarifave për lëshimin e dokumenteve ligjore për transferimin ndërkombëtar të mallrave ushtarake dhe të artikujve e teknologjive me përdorim të dyfishtë, që lëshohen nga Autoriteti i Kontrollit Shtetëror të Eksporteve”, shfuqizohet.

4. Ngarkohet Autoriteti i Kontrollit Shtetëror të Eksporteve për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

Lidhja nr.1

Tarifat për lëshimin e dokumenteve ligjore për transferimin ndërkombëtar të mallrave ushtarake dhe të artikujve e teknologjive me përdorim të dyfishtë

	Shërbimi	Tarifa në lekë
1.	Licencë individuale eksporti për mallra ushtarake	10 000
2.	Licencë individuale për eksport të përkohshëm për mallrat ushtarake	10 000
3.	Licencë individuale për riekспорт për mallra ushtarake	10 000
4.	Licencë individuale importi për mallra ushtarake	10 000
5.	Licencë individuale për import të përkohshëm për mallrat ushtarake	10 000
6.	Licencë individuale për transit ndërkombëtar të mallrave ushtarake	10 000
7.	Licencë individuale për <i>transship</i> ndërkombëtar të mallrave ushtarake	10 000
8.	Licencë individuale për veprimtari ndërmjetësuese (<i>brokerage</i>) për mallrat ushtarake	10 000
9.	Autorizim për negociim të marrëveshjeve ndërkombëtare për mallra ushtarake për vendet nën embargo	10 000
10.	Certifikatë e regjistrimit për mallrat ushtarake	100 000
11.	Certifikatë ndërkombëtare importi për mallra ushtarake	10 000
12.	Certifikatë e përdoruesit të fundit për mallra ushtarake	10 000

13.	Certifikatë e mbërritjes së mallit në destinacion (DVC) për mallra ushtarake	10 000
14.	Licencë individuale eksporti për artikujt dhe teknologjitë me përdorim të dyfishtë	5 000
15.	Licencë globale eksporti për artikujt dhe teknologjitë me përdorim të dyfishtë	10 000
16.	Licencë e përgjithshme eksporti për artikujt dhe teknologjitë me përdorim të dyfishtë	10 000
17.	Licencë individuale për eksport të përkohshëm për artikujt dhe teknologjitë me përdorim të dyfishtë	5 000
18.	Licencë individuale për riekport për artikujt dhe teknologjitë me përdorim të dyfishtë	5 000
19.	Licencë individuale importi për artikujt dhe teknologjitë me përdorim të dyfishtë	5 000
20.	Licencë globale importi për artikujt dhe teknologjitë me përdorim të dyfishtë	10 000
21.	Licencë e përgjithshme importi për artikujt dhe teknologjitë me përdorim të dyfishtë	
22.	Licencë individuale për import të përkohshëm për artikujt dhe teknologjitë me përdorim të dyfishtë	5 000
23.	Licencë individuale për veprimtari ndërmjetësuese (<i>brokerage</i>) për artikujt dhe teknologjitë me përdorim të dyfishtë	5 000
24.	Licencë individuale për transit ndërkombëtar të artikujve dhe teknologjive me përdorim të dyfishtë	5 000
25.	Licencë individuale për <i>transship</i> ndërkombëtar të artikujve dhe teknologjive me përdorim të dyfishtë	5 000
26.	Licencë individuale për mallrat që nuk përfshihen në listën e miratuar për kontroll	5 000
27.	Autorizim për negociim të marrëveshjeve ndërkombëtare për artikujt dhe teknologjitë me përdorim të dyfishtë	5 000
28.	Certifikatë ndërkombëtare importi për artikujt dhe teknologjitë me përdorim të dyfishtë	5 000
29.	Certifikatë e përdoruesit të fundit për artikujt dhe teknologjitë me përdorim të dyfishtë	5 000
30.	Certifikatë e mbërritjes së mallit në destinacion (DVC) për artikujt dhe teknologjitë me përdorim të dyfishtë	5 000
31.	Licencat për projekte të mëdha për artikujt dhe teknologjitë me përdorim të dyfishtë	10 000
32.	Lëshim dublikate i licencës/certifikatës/autorizimit të dhënë	3 000